

forum  
2015

Projekt i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Projekat Kosovske Fondacije za Otvoreno Društvo  
Project of the Kosovo Foundation for Open Society

ÇËSHTJET QË E FRENOJNË  
ZHVILLIMIN NË KOSOVË

REPUBLIKA

PËRGGJIGJE NDAJ SFIDAVE  
TË RRITJES EKONOMIKE

TETOR 2017

RIINVEST  
1995



forum  
2015

Projekt i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Projekat Kosovske Fondacije za Otvoreno Društvo  
Project of the Kosovo Foundation for Open Society

ÇËSHTJET QË E FRENOJNË  
ZHVILLIMIN NË KOSOVË

REPUBLIKA

# PËRGGJIGJE NDAJ SFIDAVE TË RRITJES EKONOMIKE

TETOR 2017

RIINVEST  
1995



Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur - KFOS

Autorët:

Enisa Serhati - Riinvest

Dita Dobranja - Riinvest

Muhamet Mustafa - Riinvest

Pëllumb Çollaku - Riinvest dhe wiiw

Tetor 2017

Publikuar nga: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

Imzot Nikë Prelaj, Nr. 13, 10 000 Pristina Kosovë

Për më shumë informata: [info@kfos.org](mailto:info@kfos.org) [www.kfos.org](http://www.kfos.org)

# PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	6
INVESTIMET .....	12
AFTËSIA KONKURRUESE DHE TREGTIA E JASHTME .....	18
RIORIENTIMI I POLITIKAVE EKONOMIKE (REKOMANDIME) .....	26
REFERENCAT .....	28



# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport<sup>1</sup> synon të përmirësojë informacionin **lidhur me momentin aktual në trendët ekonomikë dhe t'i kontribuojë përmirësimit të mëtejshëm të politikave me të cilat duhet t'u jepet përgjigje më të suksesshme sfidave që ngadalësojnë rritjen ekonomike. Përqendrimi i këtyre politikave padyshim duhet të jetë në investime, punësim dhe tregti të jashtme.** Raporti është përgatitur në bazë të të dhënave nga ASK, MF, BQK, raporteve të FMN-së dhe BB-së si dhe diskutimeve paraprake me ekspertë të pavarur dhe atyre që punojnë në institucione. Raporti me rekomandime do të prezantohet në Forum 2015 në formatin standard të forumit me pjesëmarrje të akterëve të interesuar. Diskutimi në Forum 2015 do të pasohet me avokim – media, diseminim të politikëbërësit.

Situata ekonomike në Kosovë karakterizohet ende me shpërpjesëtimet makroekonomike të cilat reflektohen para së gjithash në papunësinë e lartë (27-30%) dhe në deficitin e lartë tregtar (30-35% të GDP-së). Rritja ekonomike ka vazhduar gjatë gjithë dekadës së fundit por nuk ka qenë e qëndrueshme dhe as afër nivelit të domosdoshëm karshi

sfidave të zhvillimit të Kosovës. Ndonëse e përmirësuar nga 1.2% në vitin 2014 (2-3% në vitet paraprake) në rreth 4% në dy vjetët e fundit dhe në gjysmën e parë të këtij viti, ende nuk ka arritur nivelin që të adresojë suksesshëm e në mënyrë të qëndrueshme papunësinë dhe diferencat në zhvillim me pjesën tjetër të Evropës. Duket se modeli i deritashëm i rritjes ekonomike nuk mund të servsojë rritjen ekonomike që i nevojitet Kosovës. Fakti se sektorët e industrisë përpunuese marrin pjesë vetëm 12% në kreditë investuese, se importi vjetor i pajisjeve është 70-94 milion, se këta sektorë marrin pjesë vetëm 10% në investimet e jashtme direkte, pasqyron qartë limitet e këtij modeli. Masat e politikave fiskale, gjatë dy viteve të fundit, po japin efekte fillestare pozitive, por ato duhet të fuqizohen me një sistem të integruar politikash e masash gjithpërfshirëse për rritjen e ofertes vendore. Konsiderohet se me këtë nivel të rritjes ekonomike, Kosova do të përballlet me vështirësi serioze jo vetëm në balancimin me problemet sociale-ekonomike dhe kohezionin social por edhe në integrimin e suksesshëm në BE, me forcimin e pozitës së saj ndërkombëtare si dhe konsolidimit të

1. Ky raport është pjesë e një studimi më të gjerë të përgatitur nga Instituti Riinvest (Muhamet Mustafa, Pëllumb Çollaku, Enisa Serhati dhe Dita Dobranja)



proceseve të zhvillimit demokratik dhe institucional. Rritja ekonomike afatgjatë dhe e qëndrueshme që do t'i zvogëlonte diferencat në zhvillim me vendet e rajonit dhe BE-në, është çështja më e rëndësishme strategjike, një prioritet rreth të cilit duhet të konvergjojnë masat dhe politikat edhe në rrafshin ekonomik edhe në atë politik.

Shtrohet pyetja se cilat janë problemet kryesore me modelin e tashëm të rritjes ekonomike në Kosovë? Ky raport gjen se problemet kryesore janë:

- 1 Dinamika e pamjaftueshme dhe ritmi jo i qëndrueshëm i rritjes ekonomike.
- 2 Investimet e pamjaftueshme në krijimin ofertës vendore (produktet dhe shërbimet), veçanërisht në industri përpunuese dhe shërbime me vlerë të lartë të shtuar.
- 3 Eksporti i vogël, struktura e tij e pavolitshme dhe raportet jo të volitshme dhe jo simetrike tregtare në rajon dhe më gjerë.

4 Modeli i tashëm i zhvillimit dhe rritjes ekonomike ka sjellë deri te një pozitë inferiore të sektorëve prodhues (industrisë përpunuese) në kredi, në eksport, në investimet e jashtme dhe import të pajisjeve.

5 Gjenerimi i pamjaftueshëm i vendeve të punës, papunësia e lartë dhe si rrjedhim ritme të papranueshme të synimeve për emigrim te gjeneratat e reja.

Papunësia e lartë është pasojë e problemeve të listuara prej 1-4, andaj përqendrimi në këtë raport është jo në përshkrimin e dimensioneve të saj (të diskutuara shpesh në shoqëri) por para së gjithash në përshpejtimin e rritjes ekonomike nëpërmjet rritjes së investimeve, rritjes së aftësisë konkurruese dhe rritjes së eksportit dhe përmirësimit të politikave tregtare.



**TABELA 1:** Bruto Produkti Vendor për kokë banori në Ballkanin Perëndimor, periudha 2010–2016, vlera në euro

Ekonomia	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Shqipëria	3100.0	3200.0	3300.0	3300.0	3500.0	3500.0	3700.0
Bosnjë e Hercegovina	3400.0	3500.0	3500.0	3900.0	4000.0	4200.0	4300.0
Kosova	<b>2500.0</b>	<b>2700.0</b>	<b>2800.0</b>	<b>2900.0</b>	<b>3100.0</b>	<b>3200.0</b>	<b>3400.0</b>
Maqedonia	3500.0	3700.0	3700.0	3900.0	4100.0	4400.0	4800.0
Mali i Zi	5000.0	5300.0	5100.0	5400.0	5600.0	5900.0	6400.0
Serbia	4100.0	4600.0	4400.0	4800.0	4700.0	4700.0	4800.0

BURIMI: INSTITUTI I VJENËS PËR EKONOMI NDËRKOMBËTARE, (2017)

## Vështrim mbi modelin aktual të rritjes ekonomike

Shtetet e Ballkanit Perëndimor (BP) ku bën pjesë dhe Kosova, pas kolapsit të ish-Jugosllavisë kanë ndjekur një model karakteristik të zhvillimit ekonomik, i bazuar kryesisht në integrimin në Bashkimin Evropian (BE), ndikimet financiare dhe remitencat (Komisioni Evropian, 2009b). Ky model synon integrimin politik, tregtar, dhe financiar (të gjitha këto me kushtëzime të ndryshme varësisht nga shkalla e integritit drejt BE-së). Ky orientim vazhdon të jetë në agjendën e Kosovës, por është duke hasur në vështirësi në rrugën e krijimit të një rritjeje të qëndrueshme ekonomike, që rrjedhimisht shtrën rrugën për në BE. Kjo vërehet qartë nga tabela e mëposhtme të Bruto Produktit Vendor (BPV) për kokë banori, ku Kosova renditet e fundit nga vendet e rajonit.

Ndonëse me disa shenja përmirësimi sa i përket rritjes ekonomike, uljes së lehtë të papunësisë dhe stabilitetit makroekonomik e fiskal, situata ekonomike ende karakterizohet me çalime të mëdha në dy drejtime: i) gjenerimi i deficitit të madh tregtar; dhe ii) niveli i lartë i papunësisë.

Deficiti i madh tregtar është rezultat i shumë faktorëve të tjerë - kapaciteti prodhues vendor, aftësia konkurruese e prodhuesve në tregun vendor dhe të jashtëm, kualiteti i infrastrukturës, i edukimit, etj., dhe kërkon një shpjegim të shkurtër. Liberalizimi tregtar është faktori kryesor në ndërtimin e një ekonomie të hapur dhe të fuqizimit të aftësisë konkurruese të ekonomisë, në mënyrë që të përballet me importet dhe të hapë rrugën e rritjes së eksporteve. Për Kosovën, si një ekonomi e vogël, në rrugën që ka zgjedhur për një ekonomi të hapur dhe tregti të lirë mbase është opsioni





më pak i dëmshëm, por konteksti dhe procesi i liberalizimit meriton vëmendje.

Liberalizimi tregtar ndodhi në rrethana më specifike në krahasim me vendet e tjera në regjion, sepse u përball me pasojat e luftës, transicionin e vonuar në krahasim me shtetet e tjera të regjionit, mungesën e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale, deindustrializimin e vrazhdë në vitet e 90-ta, privatizimin me shumë mungesa pas vitit 2002 e që u reflektuan në nivelin e ulët të ofertës vendore të produkteve dhe shërbimeve. Kur kësaj i shtojmë instrumentet tregtare asimetrike dhe mungesën e politikave për mbrojtjen e prodhuesit në fazën fillestare të liberalizimit, fotografia del edhe më e qartë. Kosova dallon nga vendet e tjera të rajonit në kuptimin që ato e futën liberalizimin në kuadër të reformave të përgjithshme ekonomike, ndërsa Kosova e bëri këtë pa një strategji të rigjenerimit ekonomik nën presionet e emergjencave të rindërtimit dhe kolapsit të sektorëve prodhues gjatë viteve të 90-ta dhe gjatë luftës.

Në Kosovë duket se ka vazhduar të mungojë një kornizë e integruar e politikave ekonomike për ndërtimin e aftësisë konkurruese e mbështetje të eksportit siç e kishte sugjeruar RIINVEST që në vitin 2003. Ky fakt vazhdon të ketë efekte jo të kënaqshme në rritje ekonomike, ulje të papunësisë, investime dhe deficit tregtar. Më saktësisht, defektet burojnë nga kapaciteti i zbehtë prodhues që reflekton në eksporte modeste që janë në shpërpjesëtim të madh me importet - 10% e eksporteve mbulojnë importet e produkteve. Kjo ilustron fare mirë më poshtë, kur shihet pozita shumë

e deprimuar e industrisë përpunuese në kredi bankare, pjesëmarrja tejet modeste e këtyre sektorëve në investimet e jashtme direkte, dhe vlerat modeste të importit të pajisjeve për këtë sektor e që flet gjithashtu për një aktivitet modest investues.

Politikat ekonomike aktive që promovojnë eksportet janë shumë të nevojshme në këtë situatë. Eksperiencia e shteteve të tjera në transicion që kanë liberalizuar tregtinë (Polonia, Hungaria, Çekia), tregon që në fazat e hershme janë përballur me vështirësi, mes tjerash rënie e të ardhurave në buxhet dhe paaftësisë së sektorëve të ndryshëm vendorë që të bashkëpunojnë me konkurrencën e jashtme, por sigurimi i një ambienti miqësor dhe stabil për biznes ka qenë atraktiv për investitorët e huaj, që përmes investimeve të jashtme direkte (IJD) ofruan kapital të konsiderueshëm, duke rimëkëmbur dhe kontribuar në një rritje të qëndrueshme ekonomike në kornizat afatmesme dhe afatgjata. Me gjithë trendit të lehtë pozitiv, Kosova vazhdon të ngecë edhe në joshjen e investitorëve të huaj, e sidomos në sektorët prodhues, ndërsa viteve të fundit trendi është rënës pikërisht në këta sektorë.

Evidenca e studimeve të ndryshme tregon se nëse procesi i liberalizimit është në një vijë me reformat ekonomike, transicioni është më i lehtë, ndërsa përkrahja institucionale në këtë fazë është e domosdoshme. Nga këtu, Kosova ka nevojë t'i koordinojë së pari veprimet në këtë drejtim. Kjo vërtetohet edhe nga Balkan Business Barometer (2017), ku theksi kryesor vihet në nevojën e politikave dhe institucioneve



Performanca e bizneseve, pavarësisht sektorit, kryesisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) varet pikërisht nga barrierat që burojnë nga sistemi ekonomik dhe biznesor që i rrethon ato, e në këtë rast nga tregjet - financimi, konkurrenca dhe nga qeveria - tatimet, legjislacioni dhe burokracia.

të qëndrueshme si dhe implementimit të tyre, të cilat vazhdojnë të jenë pengesat kryesore drejt një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe shkallë më të lartë të punësimit.

Sektori i prodhimit ka qenë mjaft i rëndësishëm në zhvillim ekonomik të shumë shteteve me të ardhura të ulëta falë tri fakteve – absorbimit të teknologjisë nga jashtë dhe rritjes së produktivititetit dhe vendeve të punës; mundësisë për punësim të fuqisë punëtore të pakualifikuar duke rritur shkathtësitë e tyre me shpenzime minimale; dhe moskushtëzimi i prodhimit nga të ardhurat vendore (mundësia për eksportim të produkteve dhe shërbimeve (Rodrik, 2017). Kosova do të përmirësonte aktivitetin e saj ekonomik duke u fokusuar pikërisht në këtë trajektore.

Meqenëse sektori privat është mjaft i rëndësishëm në këtë rrugëtim, përkrahja e tij do të sillte përfitime të shumta në të ardhmen. Performanca e bizneseve, pavarësisht sektorit, kryesisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) varet pikërisht nga barrierat që burojnë nga sistemi ekonomik dhe biznesor që i rrethon

ato, e në këtë rast nga tregjet - financimi, konkurrenca dhe nga qeveria - tatimet, legjislacioni dhe burokracia.

Duke ditur se deficitit i madh tregtar gjeneron shpërpjesëtime makroekonomike me implikime afatgjata në rritjen ekonomike dhe qëndrueshmërinë e saj, zbutja e shpërpjesëtimeve të tilla duhet të jetë prioritet afatgjatë. Politikat e nevojshme ekonomike për të tejkaluar këtë situatë duhet të orientohen në rritjen e kapaciteteve prodhuese të mallrave dhe shërbimeve, aftësisë konkurruese dhe promovimit të eksportit. Kjo jo vetëm që do të përmirësonte performancën, por gjithashtu do të kontribuonte edhe në zbutjen e papunësisë që në Kosovë ka përmasa shqetësuese.

Një pjesë e deficitit tregtar po mbulohet nga remitencat e diasporës që janë rekord në regjion falë numrit të madh të mërgimtarëve që jetojnë dhe veprojnë jashtë, ndërsa donacionet ndërkombëtare ka kohë që janë venitur. Kreditë në sektorin e biznesit lënë për të dëshiruar, ndërsa i tërë sistemi pothuajse bazohet në masat që stimulojnë rritjen ekono-



mike përmes kërkesës. Një model i tillë ka qenë edhe i dirigjuar nga kushtet me të cilat Kosova u përball pas luftës: rindërtimi i vendit, politikat asimetrike tregtare që u cekën më lartë, politikat e pafavorshme ekonomike dhe pengesat administrative me të cilat Kosova u përball në rrugët e saj tregtare. Megjithatë lënia pas dore në kontinuitet për një dekadë e gjysmë e politikave ekonomike në dobi të rritjes së ofertës (supply side policies) së produkteve dhe shërbimeve vendore për një dekadë e gjysmë është një dobësi serioze e qeverisjes ekonomike në Kosovë.

Kushtet financiare sa i përket normave të interesit janë në përmirësim. Por sektori financiar i Kosovës kryesisht është i dominuar nga bankat dhe i pa integruar mirë me tregjet e tjera financiare dhe ato të kapitalit. Ndoshta kjo është edhe një arsye e vonimit të Kosovës që të kapet me shtetet e tjera dhe të arrijë rritjen e saj ekonomike duke u bazuar në potencialin që ka.

Viteve të fundit Kosova ka pasur disa investime publike. Zakonisht në ekonomitë me papunësi të lartë, si rasti i Kosovës, investimet publike mund të gjenerojnë punësim, duke rritur investimet në sektorin privat dhe rritjen e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik. Shpenzimet publike në infrastrukturë kanë ndikuar në aktivitetin ekonomik por infrastruktura ka nevojë ende për përmirësime, e sidomos në fushën e hekurudhave dhe lidhjeve rajonale me shtetet e rajonit. Kjo do të prodhonte stimuj jo vetëm për investime vendore por gjithashtu do ndikonte edhe në rritjen e interesimit nga investitorët e huaj.

Shenjë e mirë duket të jetë edhe iniciativa për përmirësimin e infrastrukturës së rajonit në kuadër të Procesit të Berlinit. Kjo do t'i përmirësonte gjithashtu perspektivat ekonomike jo vetëm për Kosovën por dhe rajonin.

Në kuadër të agjendës për integrim në BE, agjenda e reformave strukturale është në vijim e sipër edhe pse me disa ngecje. Tatimet dhe sistemi rregullativ ndër të tjera mbesin një shqetësim. Perceptimi i lartë për korrupsionin lë të kuptojë që tatimet e paguara nuk përthehen në benefite publike që do të përmirësonin ambientin ekonomik. Gjithashtu paanshmëria në sistemin rregullativ ende lë për të dëshiruar, pasi që ekziston një perceptim që nuk gjykohet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Sigurisht se zbatimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit dhe efikasiteti i gjykatave në trajtimin e konteksteve biznesore ka rëndësi qenësore. Por në këtë raport përqendrimi është te disa aspekte që janë fare pak objekt i debatit në shoqëri.

**Ambienti i përgjithshëm politik dhe institucional** duket që nuk po e përkrah mjaftueshëm rritjen ekonomike. Pak përmirësime janë bërë në këtë aspekt (Balkan Business Barometer, 2017). Sipas këtij studimi, tatimet shihen si një barrë sepse nuk shihet që ato blejnë të mirat dhe shërbimet e nevojshme publike dhe me shumë janë një barrë e panevojshme për biznese. Një problem i madh në këtë aspekt vazhdon të jetë korrupsioni, që si duket është përkeqësuar më shumë sesa përmirësuar. Pasiguria dhe jostabiliteti politik duket të jenë pengesat kryesore për një performancë më të mirë ekonomike.



# INVESTIMET


Për nivelin e zhvillimit ekonomik të Kosovës (vend me të ardhura mesatare të ulëta, me probleme në punësim dhe deficit të lartë tregtar), niveli i investimeve përgjithësisht, e sidomos investimeve që burojnë nga sektori privat, konsiderohet i pamjaftueshëm si përkrah nevojave ashtu edhe përkrah mundësive. Investimet, si përqindje e Produktit të Brendshëm Bruto (rreth 25%) për një vend i cili synon rritje ekonomike mbi 4% janë shumë të ulëta. Ato do të mund të ngriteshin në rreth 30-32% të GDP-së. Kjo do të thotë një rritje e vëllimit të investimeve të gjithëmbarshme prej rreth 400-500 milionë Euro. Duke marrë parasysh se investimet publike kanë arritur në limitet e tyre, atëherë këto investime duhet të vijnë nga sektori privat, vendor dhe i jashtëm. Problemi lidhur me investimet nuk ka të bëjë vetëm me vëllimin e tyre. Për më keq investimet vendore, posaçërisht, janë tejet të koncentruara në ekonomitë familjare dhe brenda ekonomisë kryesisht në tregti. Përveç nivelit relativisht të ulët, investimet e sektorit privat në Kosovë, po ashtu, nuk kontribuojnë në masën e domosdoshme në realizimin e potencialit të rritjes ekonomike të bazuar në investime. Këto investime janë të koncentruara në sektorë të cilët kanë potencial të limituar për rritje dhe ofrojnë nivel shumë të ulët të vlerës së shtuar.

Mungesa e statistikave paraqet problem për analizë të mirëfilltë ekonomike në Kosovë. Mungesat në statistika janë evidente sidomos për prodhimin, investimet dhe punësimin. Mungesa e të dhënave rreth investimeve, posaçërisht atyre vendore në Kosovë, paraqet një ndër problemet kryesore në analizën e këtij sektori dhe krijimin e politikave publike relevante bazuar në të dhëna. Përveç mungesës së të dhënave të përgjithshme, Kosova gjithashtu ka mungesë të të dhënave të disagreguara sipas sektorëve dhe nivelit të investimeve. Hendeku i mungesës së të dhënave duhet efektivisht të mbulohet nga tregues të përafërt të cilët japin një pasqyrë të investimeve të bëra nga sektorë të ndryshëm. Në mungesë të statistikave të përmendura në këtë raport, për t'i analizuar investimet e sektorit privat në Kosovë, kemi përdorur nivelin e kredive të marra nga bizneset nga bankat vendore – të disagreguara nëpër sektorë si dhe importin e pajisjeve nga sektori privat.

Analiza e kredive të sektorit privat është bërë në dy aspekte, në aspektin e sektorëve specifikë dhe maturitetit. E para analizon rritjen dhe lëvizjet potenciale të huamarrjes nëpër sektorë dhe krahason sektorët në mes vete. E dyta duke e përdorur maturitetin si tregues të përafërt për investime më afatgjate.




**FIGURA 1:** Niveli i kredive sipas sektorit si përqindje e totalit 2016



BURIMI: BANKA QENDRORE E KOSOVËS (2017)

**FIGURA 2:** Kreditë sipas sektorit në fund të 2016-s (në miliona euro)




BURIMI: BANKA QENDRORE E KOSOVËS (2017)

kredive për biznese private si dhe ka shënuar rritjen më të madhe në terma absolutë. Kjo reflekton dobësitë e modelit të tashëm zhvillimor në Kosovë si ekonomi të bazuar në import për t'i përmbushur nevojat e konsumit e jo në zhvillimin e kapaciteteve prodhuese për të siguruar një ofertë më të madhe vendore. Sa i përket prodhimit, niveli i huave të marra nga ky sektor, si sektori me potencialin më të madh për zgjerim dhe ndikim pozitiv në rritje ekonomike e eksport, mbetet relativisht i ulët (12%), me një përmirësim të ngadalshëm dytri vjetët e fundit. Përveç këtyre dy sektorëve, është me interes të analizohet edhe sektori i ndërtimtarisë, niveli i kredive të të cilit kanë shënuar rënie në dy vjetët e fundit, pas një rritjeje të dukshme në vitin 2012. Ky sektor, siç shihet edhe në analizën e investimeve të jashtme direkte, së bashku me sektorin e shërbimeve të patundshmërisë paraqesin sektorët më atraktivë për investitorët e huaj. Niveli i kredive të marra nga shërbimet e

Nga të dhënat e paraqitura më lart, shihet se ka pasur rritje të nivelit të huamarrjes në të gjithë sektorët, por tregtia me shumicë dhe pakicë ka absorbuar pjesën më të madhe të



**FIGURA 3:** Përbërja e kredive sipas maturitetit për ndërmarrje dhe ekonomi familjare si % e totalit



BURIMI: BANKA QENDRORE E KOSOVËS (2017)

patundshmërisë, po ashtu, ka shënuar ngritje të dukshme gjatë viteve të fundit – duke pasqyruar kështu edhe rritjen e investimeve në këtë sektor të ndërlidhur me investimet në ndërtimtari. Por ndikimi i këtij sektori në rritje ekonomike zvogëlohet pasi bazohet në komponentë transporti. Së fundi, sektori i bujqësisë ka pasur nivelin më të ulët të rritjes. Kjo, përveç nivelit të ulët të zhvillimit të bujqësisë në Kosovë, gjithashtu mund të jetë edhe rezultat i numrit të konsiderueshëm të mundësive jo-kreditore të financimit – si subvencionet dhe grantet që kanë sjellë pak përmirësime. Sektorët e tjerë, siç shihet në tabelën gjithëpërfshirëse në Aneksin 1, paraqesin nivel më të ulët të kredive të marra.

Për nga niveli i maturitetit, shumica e kredive me maturitet të lartë, do të thotë 5-10 vjet dhe mbi 10 vjet, u janë dhënë korporatave jofinanciare dhe ekonomive familjare. Në mungesë të disagregimit më të thellë nëpër sektorë, mund t'i analizojmë vetëm investimet në tërësi.

Përveç nivelit të kredive, Riinvest ka analizuar edhe nivelin e importeve të makinerisë për prodhim në sektorë të ndryshëm, për të analizuar potencialin e rritjes së prodhimtarisë në këta sektorë. Këto të dhëna tregojnë që sektori i prodhimtarisë së letrës dhe produkteve të letrës ka pasur nivelin më të lartë të importimit të makinerisë në total nëpër vite. Kjo ndodhi në vitin 2010, kur vlera e importeve të makinerive për printim ishte gati katër herë më e lartë sesa mesatarja e viteve pasardhëse.



**TABELA 2:** Importi i makinerisë nëpër vite (në miliona euro)


Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>TOTAL</b>	<b>€ 97.01</b>	<b>€ 62.17</b>	<b>€ 68.52</b>	<b>€ 61.40</b>	<b>€ 66.60</b>	<b>€ 72.88</b>	<b>€ 94.26</b>

BURIMI: DOGANA E KOSOVËS (2017)

Në sektorët e tjerë, makineritë e importuara po ashtu tregojnë një nivel të ngjashëm të luhatjes – ku vërehet nivel më i lartë i importit në një vit të caktuar, zakonisht duke reflektuar investimet e ndonjë korporate individuale, e jo të sektorit në përgjithësi. Investimet e jashtme direkte në Kosovë mund të

konsiderohen modeste pas influksit në vitet 2007 dhe 2008. Kjo rënie e entuziazmit për investime reflektohet edhe në skepticizmin e investitorëve potencialë, siç është cekur më lart në këtë seksion. Më 2016, investimet e jashtme direkte përbëjnë rreth 3.6% të Bruto Produktit Vendor.

**FIGURA 4:** Investimet e jashtme direkte në Kosovë gjatë periudhes 2004-2016



BURIMI: BANKA BOTËRORE (2017)

**TABELA 4:** Investimet e jashtme direkte në Kosovë (në miliona euro) sipas aktivitetit ekonomik, kumulativ dhe si % e totalit – (2012 - 2016)

Aktiviteti ekonomik	Total IJD 2012 – 2016	Si % e totalit
Miniera, industri ekstraktuese	626.7	4%
Industri prodhuese	1,430.80	10%
Energjetikë	817.2	5%
Ndërtimtari	791.7	5%
Tregti me shumicë dhe pakicë	362.6	2%
Informatikë dhe komunikime	747.8	5%
Ndërmjetësim financiar	1,689.10	11%
Patundshmëri	3,457.60	23%
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	125.3	1%
Aktivitete administrative dhe shërbime	437.5	3%
Aktivitete tjera të paklasifikuara	4,345.00	29%
<b>Total</b>	<b>14,969.00</b>	<b>100%</b>

BURIMI: BANKA QENDRORE E KOSOVËS (2017)

Krahas nivelit të investimeve të jashtme, problemi qenësor ndërlidhet edhe me sektorët në të cilët është investuar. Tabela 3 ilustron këtë gjendje të pakënaqshme.


Niveli i lartë i investimeve në patundshmëri paraqet investime në blerjen e patundshmërive, investime këto të cilat nuk paraqesin potencial për multiplikim të nd-

ikimit ekonomik. Kështu, përveç nivelit të investimeve të jashtme, fokusi duhet të jetë mbi të gjitha në tërheqjen dhe kanalizimin e investimeve në sektorët me potencial të zhvillimit dhe zgjerimit. Të dhënat pasqyrojnë trend rritës të investimeve të jashtme në sektorin e patundshmërisë, ndërsa trend rënës në industri prodhuese, e cila ka potencial për rritje ekonomike.





**FIGURA 5:** Investimet e Jashtme Direkte nëpër vite në sektorët e industrisë dhe patundshmërisë (në miliona euro)



Investimet e jashtme në Kosovë deri më tani nuk ngjan të jenë në sektorë që nxisin zhvillimin ekonomik, e posaçërisht jo në sektorët e prodhimit industrial - sektori kyç i zhvillimit të potencialit eksportues (trendi është rënës siç do të shihet në pjesët në vazhdim). Edhe kapitali i huaj i paklasifikuar që kryesisht përfshin huat ndërkuftare të cilat në periudha të caktuara kaluan edhe vlerën e IJD shfaqen jostabile. Shpjegim mund të jenë huat e bankave nga jashtë për të stimuluar kreditimin.

Për të trasuar rrugën drejt zhvillimit ekonomik, politikat duhet të fokusohen drejt rritjes së nivelit të investimeve dhe koncentrimin e investimeve, si vendore ashtu edhe të jashtme, në sektorët me potencial më populziv për rritje ekonomike. Kjo duhet të fillojë me identifikimin e sektorëve që kanë trend

dhe potencial rritës, dhe të pasohet me dizajnin e politikave ekonomike të cilat stimulojnë zhvillimin e këtyre sektorëve dhe promovojnë investimet në këta sektorë.

Për të krijuar rritje ekonomike të bazuar në investime dhe të tillë që të jetë e qëndrueshme. Veç asaj që u tha se Kosova duhet të ndryshojë vizionin ekonomik, në mënyrë që investimet të jenë rreth 30%-32% të BPV-së, dhe të tilla që së paku 2/3 e nivelit të investimeve të jenë nga sektori privat, jo nga ai publik. Nga sektori privat fokus të veçantë duhet t'i jepet investimit në industri dhe shërbime me vlerë të lartë të shtuar, investime në hulumtim dhe zhvillim, në industri prodhuese. Ndërsa sektori publik duhet të fokusohet në investime në kapitalin njerëzor, të tilla në sektorin e arsimit dhe të trajnimeve profesionale.



# AFTËSIA KONKURRUESE DHE TREGTIA E JASHTME

Aftësia e ulët konkurruese e Kosovës në tregun ndërkombëtar manifestohet në bilancin negativ tregtar të vendit. Kjo përbën një nga problemet themelore të rritjes ekonomike dhe zhvillimit. Figura 6 tregon deficitin tregtar të produkteve, i cili si pjesë e ekonomisë përbën gati 40 për qind të BPV-së në Kosovë. Bilanci tregtar negativ është një manifestim i kapaciteteve të ulëta të prodhimit dhe kërkesës së ulët për eksporte kosovare, pas periudhës së deindustrializimit që e shoqëroi vendin në vazhdimësi nga vitet e 90-ta.


Mungesa e kapaciteteve prodhuese ka rezultuar në një strukturë të eksporteve e cila është e kufizuar vetëm në produkte të teknologjisë së ulët, përfshirë kryesisht materialet e papërpunuara, metalet, mineralet dhe plastikën. Baza e pazhvilluar e prodhimit kështu ka krijuar varësi në mallrat që importohen kryesisht nga vendet e rajonit dhe ato të Evropës Perëndimore.

Tabela 4. më poshtë tregon dukshëm që brenda volumit të ulët të eksporteve të mallrave nga Kosova, kontributi i industrisë përpunuese është shumë i vogël. Pra në rastin kur eliminohet lënda e parë si eksport nga Kosova, industria përpunuese vërehet se përbën rreth 25-30 për qind të bazës së eksportit total.

Ngjashëm me rajonin, sektori i shërbimeve mbetet pjesa më e rëndësishme e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik në Kosovë. Këta sektorë përbëjnë deri në 70 për qind të GDP-së dhe rreth 80 për qind të totalit të punësimit në vend (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2016). Figura 7. tregon se aktiviteti brenda këtij sektori ekonomik është rritur në vazhdimësi si pjesë e BPV-së, duke shënuar po ashtu ngritje në volumin e eksporteve të shërbimeve nga Kosova dhe duke mbajtur në tërësi në bilanc pozitiv tregtar.



**FIGURA 6:** Tregtia ndërkombëtare e mallrave në Kosovë në miliona euro, dhe si % e BPV-së (2005-2016)



BURIMI: BANKA QENDRORE E KOSOVËS (2017)

**TABELA 5:** Kontributi i industrisë përpunuese në eksportet e mallrave kosovare në miliona euro (2013-2015)


Viti	2010	2011	2012
<b>TOTALI</b>	<b>293,844</b>	<b>324,543</b>	<b>325,294</b>
<b>EKSPORTI I INDUSTRIË PËRPUNUESE*<sup>2</sup></b>	<b>97,631</b>	<b>88,735</b>	<b>82,090</b>
<b>SI % E TOTALIT</b>	<b>33%</b>	<b>27%</b>	<b>25%</b>

BURIMI: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS (2017).

<sup>2</sup> Në llogaritjen e madhësisë së industrisë përpunuese në Kosovë janë përfshirë këto eksporte: yndyrëra, ushqime, pije, pije al-koholike dhe duhan, produkte të industrisë kimike, plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre, lëkurë dhe artikuj prej tyre, druri dhe artikuj druri, letër dhe artikuj prej letre, tekstil dhe artikuj tekstili, veshëmbathje të këmbëve, artikuj prej guri, allçie, prod. qeramike dhe gelqi, makineri, pajisje mekanike dhe elektrike



**FIGURA 7:** Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve në Kosovë në miliona euro, dhe si % e BPV-së (2005-2016)



BURIMI: BANKA QENDRORE E KOSOVËS (2017)


Sektorët e shërbimeve të cilët janë shumë me rëndësi për bilancin pozitiv tregtar të shërbimeve janë 'Udhëtimi', dhe 'Mallrat dhe shërbimet qeveritare' (Tabela 3). Të dy këto kategori lidhen me shpenzimet e qytetarëve jorezidentë në vend (jo kosovarë). 'Udhëtimet', fillimisht, sipas BQK-së paraqesin shërbimet që u ofrohen jorezidentëve gjatë udhëtimeve në Kosovë ose shërbimet që u ofrohen rezidentëve të Kosovës gjatë udhëtimeve jashtë vendit. Ndërsa 'Mallrat dhe shërbimet qeveritare' paraqesin transaksionet nga ambasadat, konsullatat, organizatat ndërkombëtare, njësitë ushtarake. Pra, të dy këto kategori të shërbimeve nuk paraqesin industri premtuese për zhvillimin e vendit. Sektori më premtues për rritjen e ofertës për

vende pune brenda kategorisë së shërbimeve mbetet 'Shërbimet kompjuterike' të cilat kanë mbajtur një trend aktiv të zhvillimit. Ky është një potencial që duhet mbështetur në të ardhmen. Në anën tjetër transporti ka impakt të rëndësishëm negativ, potencialisht si pasojë e barrierave të transportit të kosovarëve në rajon për shkak të statusit politik.

Varësia e tepërt e ekonomisë nga sektorë të shërbimit është e rrezikshme për ekonominë dhe aftësinë konkurruese, pasi që produktiviteti në sektorin e shërbimeve nuk rritet me ritme të shpejta sikurse në sektorin e manifakturës, duke rezultuar në një zhvillim të ngadaltë ekonomik. Përveç kësaj, sektorët e shërbimeve sikurse tregu i pasurive të pa-



**FIGURA 8:** Paga mesatare neto në Ballkanin Perëndimor në euro (2003-2016)



INSTITUTI I VJENËS PËR EKONOMI NDËRKOMBËTARE, 2017.

\* Pagat në Shqipëri janë të dhëna bruto

luajtshme paraqesin edhe kërcënime për fryrje të çmimeve, si një sektor që është më i prirë drejt një fenomeni të tillë. Në princip, për të përmirësuar konkurrueshmërinë e produkteve në një afat të shkurtër, një ekonomi mund të përdorë politikën e kursit të këmbimit për të zhvlerësuar monedhën e saj dhe për t'i bërë produktet e veta më të lira në tregun e huaj. Në Kosovë, me euron si valutë kjo gjë është bërë e pamundshme.


Në anën tjetër, marrëveshjet e tregtisë së lirë CEFTA, kufizimet jotarifore nga Serbia dhe ndonjëherë edhe nga vende të tjera, përfshirë Shqipërinë, nuk kanë dëshmuar gjithnjë në nivelin e duhur të kapacitetit vendor për të mbrojtur sovranitetin ekonomik dhe

prodhimet vendore në bazë të parimeve të reciprocitetit.

Sidoqoftë, ajo se çfarë Kosova mund të bëjë për të përmirësuar konkurrueshmërinë është rritja e pagave në përputhje me produktivitetin. Fatkeqësisht në Kosovë ka ndodhur e kundërta, ku njësitë e kostos së fuqisë punëtore në Kosovë është rritur në një shkallë më të shpejtë sesa produktiviteti, kryesisht si rezultat i rritjes së pagave në sektorin publik. Figura 8. më poshtë tregon se Kosova ka arritur të shënojë rritjen më të lartë të pagave në mes të viteve 2005-2014, duke u bërë një nga tregjet e punës me të ardhurat më të larta në rajon, por me produktivitetin më të ulët (Instituti i Vjenës për Ekonomi Ndërkombëtare, 2015).



**FIGURA 9:** Normat reale të interesit në kredi në Ballkanin Perëndimor (2004-2016)



BURIMI: BANKA BOTËRORE, 2017

## Sektori financiar dhe të hyrat kapitale

Sektori financiar luan një rol kyç në zhvillimin e sektorit privat dhe konkurrueshmërisë ekonomike dhe fokus primar ka financimin e aktiviteteve të biznesit dhe rritjen e firmave që ndikojnë në përmirësimin e nivelit të punësimit. Sektori financiar në Kosovë ka kaluar një rritje mbresëlënëse dhe të shpejtë.


Përmirësimi i ndjeshëm i kushteve të financimit nga bankat komerciale në Kosovë përgjatë dy vjetëve të fundit shihet më së miri në rënien e normave të interesit në kredi. Kjo rënie ka qenë më e larta në rajon, mbi 30 për qind më e madhe sesa rënia mesatare e normave të interesit në kredisë për vendet e

Ballkanit Perëndimor. Krahasuar me normat e interesit të vitit 2004, normat e interesit për huat janë përgjysmuar duke u zvogëluar për më shumë se 7,5 pikë përqindjeje. Krahasuar me vendet e rajonit, normat e interesit për kreditë në Kosovë mbeten më të larta sesa ato në Maqedoni dhe Bosnjë e Hercegovinë, mirëpo janë më të ulëta sesa ato të Malit të Zi, Shqipërisë dhe Serbisë.

Normat e interesit, të larta deri para një viti, kanë ndikuar keq në aftësinë konkurruese. Efektet e kësaj rënie të normave të interesit pritet t'i shohim në vitet e ardhshme, pasi që as kreditimi për investime në industri nuk duket se është përmirësuar edhe pas zvogëlimit të normave të interesit.



**FIGURA 10:** Transferet neto nga diaspora në miliona euro, dhe si % e BPV-së, (2005-2016)



BURIMI: BANKA QENDRORE E KOSOVËS (2017)

Baza e kredive në vend është rritur nga 25 pikë përqindje të BPV-së nga viti 2000 deri në vitin 2016 (Banka Qendrore e Kosovës), ndërsa kreditë e këqija përbëjnë më pak se 10 për qind të totalit të kredive, duke shënuar nivelin më të ulët të kredive të këqija në rajon.

Të hyrat kapitale përbëhen pothuajse ekskluzivisht nga transferet neto dhe IJD-të nga diaspora kosovare që jeton në Evropën Perëndimore apo në Amerikën e Veriut. Në fakt, Kosova është një nga vendet me përqindjen më të lartë të remitencave si pjesë e BPV-së në Evropë (p.sh. 16% e BPV-së për vitin 2008). Mirëpo për fat të keq, remitencat pothuajse plotësisht përdoren për të financuar

konsumin dhe deficitin tregtar, gjë që nuk i ka ndihmuar aftësisë konkurruese. Sipas Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës, 96% e remitencave që mbërrijnë në Kosovë përdoren për konsum (MTI, 2014). Për më tepër, remitencat si % e BPV-së kanë shënuar një trend rënës.

Ky model i financimit e ka mbajtur ekonominë kosovare në një rrugë të kufizuar të rritjes së konkurrencës dhe mund të ndryshohet me politika që riorientojnë remitencat drejt praktikave më produktive.



## Politika fiskale

Në mungesë të politikës monetare dhe politikës së kursit të këmbimit, menaxhimit makroekonomik në Kosovë kryesisht i mbetet të mbështetet në politikë fiskale. Prandaj, investimet publike dhe infrastruktura kanë paraqitur mundësinë kryesore që politika fiskale të sigurojë përmirësim të performancës ekonomike dhe zbutje të cikleve të biznesit përmes rritjes së produktit vendor të përgjithshëm dhe multiplikuesit fiskal.

Megjithatë, politikat ekspansioniste fiskale të Kosovës shpesh ishin rezultat i politikës dhe vendimmarrjes ad hoc. Për shembull, pas zgjedhjeve të përgjithshme në vitin 2014, pagat dhe pensionet në sektorin publik u rritën 25 për qind, dhe u sollën përfitime të reja sociale për veteranët e luftës dhe të burgosurit politikë.

Sidoqoftë, pavarësisht tendencës për vendimmarrje të udhëhequr nga zhvillimet politike, hapësira për një politikë ekspansioniste fiskale është e vogël. Kosova ka adaptuar rregullore që parandalojnë rritjen e borxhit publik deri në nivele që kërcënojnë stabilitetin ekonomik, duke përfshirë një ligj që përcakton raportin maksimal të borxhit publik - ndaj PBV-së në 30 për qind të PBV-së, dhe një rregull fiskale të rënë dakord me Fondin Monetar Ndërkombëtar - që kufizon deficitin e përgjithshëm buxhetor në 2 për qind të PBV-së.

Pakoja fiskale 1 e implementuar nga Qeveria e Kosovës në 2015, me të cilën bizneseve u janë bërë 50 milionë zbritje në taksa dhe u është dhënë më shumë hapësirë për më shumë kredi dhe import të pajisjeve, janë masa në drejtim të duhur. Pakoja fiskale 2 fuqizon këtë iniciativë edhe më shumë dhe është pozitive që edhe Qeveria e re planifikon të vazhdojë implementimin e saj.

## Kualiteti i institucioneve dhe qeverisjes

Një dimension i fundit, por i rëndësishëm së lartë në diskutimin e konkurrueshmërisë së ekonomisë është edhe kualiteti i qeverisjes dhe i institucioneve. Përgjegjësia e institucioneve qëndron në krijimin e mekanizmave që sigurojnë sundim të ligjit, stabilitet për investim dhe norma të qeverisjes korporative. Në listën e Indikatorëve Botërorë të Qeverisjes (WGI) nga Banka Botërore, Kosova ka një indikator negativ konsistent të kualitetit të qeverisjes. Ky indikator tregon perceptimin e kualitetit të qeverisjes publike, pavarësinë e shërbimit civil dhe kualitetit të krijimit të politikave. Pra, fatkeqësisht në Kosovë kualiteti i qeverisjes në dekadën e fundit në përgjithësi nuk ka qenë kontribuues pozitiv në ambientin biznesor dhe konkurrueshmërinë në nivel ndërkombëtar.





Fatkeqësisht në Kosovë kualiteti i qeverisjes në dekadën e fundit në përgjithësi nuk ka qenë kontribuues pozitiv në ambientin biznesor dhe konkurrueshmërinë në nivel ndërkombëtar.



# RIORIENTIMI I POLITIKAVE EKONOMIKE (REKOMANDIME)

Një model i ri, që do bazohej kryesisht në ofertë për të stimuluar ngecjen e sektorëve prodhues dhe sektorëve të shërbimeve, ri-industrializimit të sektorëve të minierave dhe industrive përpunuese, përmirësimit të trendit të investimeve vendore dhe atyre të jashtme dhe rritjes së eksporteve, është i nevojshëm. Ky hap do të adresonte edhe çështjen e papunësisë e cila vazhdon të mbetet në nivel të lartë dhe shqetësues. Për më tepër, Qeveria përmes stimulimit të sektorëve të prodhimit dhe mbështetjes së kushteve për eksportin e produkteve do të krijonte hapësirë për hapjen e vendeve të reja të punës dhe me të edhe rritje së kërkesës në vend.

**ANDAJ, QEVERIA E KOSOVËS  
DUHET TË ORIENTOHE T NË  
POLITIKAT TË CILAT PROMOVOJNË  
FILLIMISHT:**

1

**rritje ekonomike gjithëpërfshirëse** duke u fokusuar më shumë në zhvillimin e shkathtësive, krijimin e vendeve të punës, participim gjithëpërfshirës në tregun e punës, edukim, shëndetësi dhe mirëqenie. Në këtë drejtim emergjente është nevoja e përmirësimit të kualitetit në edukim, si një indikator shumë i rëndësishëm në rritjen e aftësisë konkurruese.

2

Marrjen e masave të integruara për të rritur vëllimin e investimeve vendore e të jashtme në sektorët e prodhimit dhe shërbimeve me vlerë të lartë të shtuar.



Për më tepër, Qeveria përmes stimulimit të sektorëve të prodhimit dhe mbështetjes së kushteve për eksportin e produkteve do të krijonte hapësirë për hapjen e vendeve të reja të punës dhe me të edhe rritje së kërkesës në vend.

3

**kualitet të qeverisjes për rritje ekonomike** duke rritur kapacitetet e administratës publike për të forcuar sundimin e ligjit dhe uljen e korrupsionit, krijimin e një ambienti lehtësues për biznes, si dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme publike për zhvillim ekonomik; dhe një orientim të qartë për rritje të ofertës vendase.

Mbështetja e industrisë përpunuese vendore duhet të jetë prioritet.

6

**një rritje ekonomike ‘të mençur’** duke stimuluar inovacionin dhe rritur aftësinë konkurruese për produktet që gjenerojnë vlerë të shtuar më shumë sesa të produkteve që varen në kosto të punës.

4

**rritje ekonomike të qëndrueshme:** duke rritur shkallën e aftësisë konkurruese në sektorin privat, lidhjes përmes zhvillimit të infrastrukturës dhe inkurajimit të një rritjeje ekonomike të bazuar në energji eficiente.

6

Investimet në infrastrukturën hekurudhore për të ulur kostot e transportit.

5

**rritje ekonomike të integruar** duke mbështetur tregtinë e lirë dhe politikën e investimeve si dhe ‘lidhjeve’ jodiskriminuese mes ndërmarrësve vendorë dhe të huaj, kontakte transparente dhe të parashikueshme;

Zbatimin e politikave tregtare që sigurojnë konkurrencë të barabartë, përmirësojnë pozitën e eksporteve në raport me barrierat jotarifore dhe zbatimin konsekuent të masave të reciprocitetit.



# REFERENCAT

Agjencia e Statistikave të Kosovës (2017), ASK Data, <http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/>

Banka Botërore (2017), Data Bank, <http://databank.worldbank.org/data/reports.aspx?source=ëorld-development-indicators#>

Banka Botërore (2017), World Governance Indicators, <http://info.worldbank.org/governance/wgi/#home>

Banka Qendrore e Kosovës (2017), seritë kohore, <http://bqk-kos.org/?id=55>

Dogana e Kosovës (2017), Databaza, Importi i pajisjeve të manufakturës

European Commission (2009b), Five years of an enlarged EU. Economic achievements and challenges, European Commission, Directorate General for Economic and Financial Affairs, Brussels

Instituti i Vjenës për Ekonomi Ndërkombëtare (2017), Cautious upturn in the CESEE: Haunted by the Spectre of Uncertainty, Forecast Report, Spring 2017

Instituti i Vjenës për Ekonomi Ndërkombëtare (2015), Policy Options for Economic Growth and Competitiveness of Kosovo, Policy Notes and Reports 15, May 2015

Instituti i Vjenës për Ekonomi Ndërkombëtare-WIIW (2017), Annual Database.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (2014), "Concept of Kosova Industrial Policy." (2014): <http://mti.rks-gov.net/desk/inc/media/0824EBAC-476D-4C47-938B-C8041612DBE0.pdf>

Regional Cooperation Council (2017), Balkan Barometer: Business Opinion Survey, Regional Cooperation Council, 100, ISSN: 2490-2586

Riinvest (2003), 'Trade Policies and Export Promotion in Kosova', Research Report, November

Rodrik, Dani (2017), 'Growth Without Industrialization', Project Syndicate.



Rritje ekonomike gjithëpërfshirëse duke u fokusuar më shumë në zhvillimin e shkathtësive, krijimin e vendeve të punës, participim gjithëpërfshirës në tregun e punës, edukim, shëndetësi dhe mirëqenie. Në këtë drejtim emergjente është nevoja e përmirësimit të kualitetit në edukim, si një indikator shumë i rëndësishëm në rritjen e aftësisë konkurruese





